



## **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

# **DISA PËRFUNDIME PARAPRAKE TË KSHH-së PËR VËZHGIMIT E FUSHATËS ZGJEDHORE DHE ZGJEDHJEVE TË 12 TETORIT 2003**

### **I. Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe vëzhgimi i procesit zgjedhor**

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është organizata e parë joqeveritare që vepron në fushën e të drejtave të njeriut me statusin e vëzhguesit dhe të reaguesit ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Prej vitit 1992, KSHH-ja është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për drejtat e njeriut. Një nga fushat e veprimtarisë së këtij Komiteti është vëzhgimi i procesit zgjedhor në Shqipëri.
- KSHH në të kaluarën, brenda mundësive që ka patur, ka vëzhguar si zgjedhjet parlamentare edhe ato për organet e qeverisjes vendore.
- Për zgjedhjet e 12 Tetorit 2003, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) akreditoi 106 vëzhgues të KSHH-së. KSHH përshëndet akreditimin e shpejtë të 106 vëzhguesve të saj nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Në fillim të muajit shtator 2003, KSHH trajnoi vëzhguesit e tij në lidhje me procesin zgjedhor, rolin e vëzhguesit dhe procedurat e vëzhgimit. Baza e këtij trajnimi ishte Kodi i ri Zgjedhor, ndërsa më vonë ata u njohën edhe me udhëzimet e ndryshme të KQZ-së.
- Për zgjedhjet e 12 Tetorit 2003, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka vëzhguar në rrethet Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Kukës. Vëzhguesit e këtij Komiteti kanë vëzhguar disa aspekte parazgjedhore, si: fushatën zgjedhore, shpalljen e listave paraprake, rishikimin e listave, ngritjen e KZQV-ve, dhe KQV-ve, trajnimi i komisionerëve, etj si dhe procesin zgjedhor gjatë ditës së votimit.

- KSHH ka nënshkruar së bashku me disa organizatat të tjera jofitimprurëse një deklaratë, më 26.09.2003, në të cilën organizatat nënshkruese shprehen për angazhimin e tyre në respektimin e legjislacionit në fuqi gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor, paanësinë, pavarësinë politike, objektivitetin, transparencën dhe përgjegjshëmrinë që ato do të kenë gjatë vëzhgimit të këtij procesi zgjedhor.
- Në konferencën e shtypit të datës 13 Tetor 2003, KSHH paraqiti disa të dhëna paraprake rreth konstatimeve të vëzhguesve të tij, ndërsa puna vazhdon me shkrimin e raportit përfundimtar ku do të trajtohen më gjerë të gjitha rezultatet e vëzhgimeve të KSHH-së, si edhe do të bëhen rekomandimet përkatëse për përmirësimin e Kodit Zgjedhor dhe procesit zgjedhor në përgjithësi.

## **II. Kodi Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së**

- Fillimisht e shikojmë të nevojshme të theksojmë se miratimi i Kodit Zgjedhor është një hap përpara drejt përmirësimit të legjislacionit zgjedhor, duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, KSHH ka mendimin se disa dispozita të Kodit Zgjedhor paraqesin probleme serioze. Në këtë drejtim, KSHH duke patur parasysh edhe praktikën e këtyre zgjedhjeve, në ditët në vazhdim do të dalë me disa sugjerime konkrete për përmirësimin e Kodit Zgjedhor.

## **III Fushata zgjedhore për zgjedhjet e 12 Tetorit 2003**

- Në bazë të kërkesave të Kodit Zgjedhor, partitë duhej të fillonin fushatën zgjedhore në 12 shtator 2003. Në realitet, partitë e mëdha e filluan fushatën më datë 30 gusht dhe 1 shtator 2003. Fushata në përgjithësi ka qenë e ekuilibruar, edhe pse nga liderët kryesorë partiakë nuk kanë munguar edhe akuzat reciproke. Mbledhjet, mitingjet janë zhvilluar normalisht-pa eksese.
- Ka patur ankesa dhe pretendime për grisje posterash dhe për ndonjë presion indirekt mbi personat që vendosnin mjete propongadistike. Organet e qverisjes vendore duhet të tregojn kujdes më të madh për caktimin e vendeve të veçanta për vendosjen e materialit propagandistik të subjekteve zgjedhore. Nga ana tjetër, subjektet zgjedhore nuk duhej të vendosnin materialet e tyre propagandistikë, vend e pa vend.
- Në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, media e shkruar dhe ajo elektronike mendojmë se ka vepruar në përgjithësi drejt, me përjashtim të ndonjë rasti që ka reaguuar edhe Bordi Monitorues si dhe KQZ. Kemi

mendimin se ky Bord e ka justifikuar qëllimin për të cilin u ngrit. Dy gazetatat e pozitës dhe opozitës (Zëri i Popullit dhe Rilindja Demokratike) herë pas here kanë përdorur gjuhë të ashpër dhe jo në përputhje me etikën gazetareske ndaj kundërshtarëve politikë ose ndaj kandidatëve të palës tjetër.

#### **IV. Listat e zgjedhësve**

- Listat paraprake të zgjedhësve u përgatitën dhe u shpallën në kohën e duhur. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka punuar intesivisht për të informuar publikut për listat e zgjedhësve duke përdorur në mënyrë më të organizuar mjete të ndryshme si median e shkruar, elektronike, spotet televizive, aksesin në internet dhe linjën telefonike falas.

- Vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar mbi disa defekte në listat e zgjedhësve si raste kur personave nuk i figuronte emri në listë, emri i tyre ndodhej në një qendër tjetër votimi, persona të së njëjtës familje nuk e kishin emrin në të njëjtën qendër votimi. Disa zgjedhës gjenin emrat e tyre në listat e afishuara, por nuk ishin në listat e qëndrave të votimit.

- Këto parregullsi natyrisht krijuan shqetësime, sidomos në ata zgjedhës që ishin të predispozuar të ushtronin të drejtën e votes. Arsyet e këtij çrregullimi mund të jenë të shumta, por ne mendojmë se kryesoret janë:

**Së pari**, pas shpalljes së listave paraprake dhe atyre përfundimtare, sipas ligjit, KZQV-të në bashkëpunim me Bashkinë dhe Komunën duhej të organizonin lajmërimin për çdo zgjedhës, për qendrën e votimit, vendndodhjen e saj, si dhe numrin e tyre në listën e zgjedhësve të qendrës së tyre të votimit (neni 56 i Kodit). Kjo dispozitë e Kodit Zgjedhor duket se nuk është zbatuar siç duhet nga KZQV-të.

**Së dyti**, pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve, një pjesë e zgjedhësve, për indiferentizëm ose të bindur se emri i tyre duhet të ishte në listë, nuk janë interesuar të njiheshin personalisht me listat. Ka patur edhe zgjedhës që edhe pse nuk e kanë patur emrin në listë nuk i janë drejtuar KZQV-së përkatëse (kërkesë kjo e nenit 57 të Kodit Zgjedhor).

**Së treti**, sipas nenit 58 të Kodit Zgjedhor, partitë politike kanë të drejtë t'i drejtohen KZQV-ve për ndryshime në listat paraprake. Ankesat e tyre pjesërisht i kanë paraqitur në media ose në konferenca shtypi dhe pjesërisht në KZQV, por pa i shoqëruar në çdo rast me kërkesat personale të zgjedhësve, gjë që vonoi dhe vështirësoi verifikimet përkatëse.

**Së katërti**, KZQV-të nuk kanë treguar kujdesin e duhur dhe nuk kanë shqyrtuar në kohën e duhur ankesat e paraqitura në këto komisione dhe nuk kanë informuar ankuesit për vendimet e marra, d.m.th. ato nuk kanë zbatuar rigorozisht nenin 57 të Kodit Zgjedhor.

- Pavarësisht nga arsyet e mësipërme që janë të karakterit subjektiv, KSHH (ashtu siç është shprehur edhe në zgjedhjet e mëparshme), mendon se defekte të tilla në këtë ose atë masë do të vazhdonin deri sa ne nuk kemi të saktë dhe të stabilizuar në përputhje me ligjin Rregjistrin e zyrave të gjendjes civile, derisa ne nuk kemi të kompjuterizuar të dhënat që kanë të bëjnë me këtë problem dhe kështu nuk ka një sistem verifikues të dhënash.
- KSHH mendon se një pjesë e këtij defekti mund të parandalohet në qoftë se do të kishte një preokupacion më të madh nga vetë zgjedhësit, nga subjektet zgjedhore (sidomos nga dy partitë e mëdha). Ky defekt mund të ishte më i kufizuar në qoftë se KZQV-të përkatëse do të zbatonin me rigorozitet dispozitat e Kodit Zgjedhor.
- E shikojmë të nevojshme të theksojmë se KSHH vëzhgon respektimin e kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe nuk bëhet pjesë e komenteve politike. Në vëzhgimin e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin, ne arrijmë në përfundime vetëm duke patur parasysh ligjin dhe informacionet e verifikueshme që kemi marrë nga vëzhguesit tanë që sigurisht janë të pjesshme dhe paraprake. Nëse defektet e vërtetuara në listat e zgjedhësve janë të qëllimshme siç pretendohet nga kjo apo ajo forcë politike, nuk na takon ne, as ta mohojmë dhe as ta konformojmë. Për këtë ka organe kompetente që mund të arrijnë në përfundimet përkatëse.

## **V. Komsioni Qëndror i Zgjedhjeve**

- Në krahasim me zgjedhjet e mëparshme kemi mendimin se ky komision ka punuar në përgjithësi mirë. Ndryshime të dukshme ka patur në drejtim të një organizimi më të mirë -të ndjekjes dhe kontrollit të çështjeve të caktuara- në drejtim të transparencës së mbledhjeve të planifikuara, në nxjerrjen e udhëzimeve. Megjithatë, kemi mendimin se disa herë veprimtaria e KQZ-së është penguar nga ndërhyrjet vend e pa vend të përfaqësuesve të partive politike pa të drejtë vote në këtë komision.
- KSHH ka studiuar të gjitha udhëzimet e KQZ-së dhe ka patur edhe ndonjë vërejtje që ia ka bërë të ditur KQZ-së si dhe do t'i trajtojë më gjerë këto çështje në në raportin përfundimtar të tij. Lidhur me përbërjen e KQZ-së, me deklaratat dhe kërkesat e bëra për balancim, me zgjedhjen e anëtarit të KQZ-së nga KLD-ja, me shtyrjen e zgjedhjes të N/kryetarit etj,

KSHH është konseguent në qëndrimet e tij: Të zbatohet Kushtetuta e RSH, të zbatohet ligji dhe Kodi Zgjedhor. Në qoftë se ky i fundit ka defekte, të bëhen propozime për përmirësimin e tij.

- Për Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, KSHH-ja e konsideron pozitive që në Kodin e Ri Zgjedhor parashikohet ngritja e një Gjykate të tillë që do të shqyrtojë, siç në fakt edhe ka shqyrtuar, ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Por të mos harrojmë se vendimet e kësaj gjykate janë të formës së prerë.

## **VI. Ngritja e KZQV-ve dhe KQV-ve si dhe trajnimi i komisionerëve**

- Ka patur vonesa në ngritjen e tyre. Shkaku është mosrespektimi i afateve të caktuara brenda të cilave partitë përkatëse politike duhet të bënin propozimet e tyre. Ngritja me vonesë e KZQV-ve dhe KQV-ve ka ndikuar negativisht edhe në vonesat në trajnimin e tyre. Vlen të përmendet se në këtë drejtim ka ndikuar negativisht edhe terheqja e një numri të antarëve të KZQV-ve dhe të KQV-ve që duheshin zëvendësuar përkatësisht nga KQZ-ja dhe KZQV-ja.
- Pavarësisht se udhëzimet e KQZ-së kanë ndihmuar në këtë drejtim, mendojmë se trajnimet e komisionerëve kanë patur boshllëqe.
- Përbërja e KZQV-ve në përgjithësi ka qenë konform ligjit, por ka patur zona të vëzhguara prej KSHH-së ku kriteret për anëtarë të KZQV-ve nuk janë respektuar siç është kriteri që përcakton që anëtarët e KZQV-së duhet të jenë me arsim të lartë, ose sekretari që duhet të ishte jurist.
- KZQV-të në përgjithësi vepruan drejt për rregjistrimin e kandidatëve, ndërsa shqyrtimi i propozimeve të partive politike për anëtarë të KQV-ve mendojmë se ka qenë disi i shpejtuar. Si rrjedhojë nuk është treguar vemendja e duhur lidhur me ato kritere ligjore që duhej të respektoheshin për të qenë anëtar i këtyre komisioneve.
- KSHH-ja ka arritur në përfundimin se partitë përkatëse politike që kanë të drejtën e propozimeve për anëtarë të KZQV-ve dhe KQV-ve nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur përzgjedhjes cilësore të tyre, përzgjedhjes në kohë dhe sipas udhëzimeve të KQZ-së. Kjo ka ndikuar negativisht në drejtim të cilësisë së korrigjimit të listave paraprake, caktimim me vonesë të qëndrave të votimit ose caktimit të tyre në vende të papërshtatshme.

## **VII. Marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të KZQV-ve dhe KQV-ve**

- Vëzhguesit tanë na kanë informuar se në disa KZQV ka patur mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve të komisionit nisur nga interesa të ngushta partiake ose sipas porosive të partive. Vlen të përmendet se disa subjekte zgjedhore, në vend që ankesat e tyre t'i parashtronin në përputhje me Kodin zgjedhor, për efekt të ndikimeve politike kanë dashur të bëjnë ato objekt në shtyp ose në konferencë shtypi.
- Të metat që kanë raportuar vëzhguesit tanë gjatë ditës së votimit kanë të bëjnë me mosnjohjen e mirë të ligjit nga anëtarët e KQV-ve, pa mohuar edhe rolin e ndikimeve partiake mbi përfaqësuesit e tyre në komisione.

### **VIII. Procesi i Votimit**

- Në përgjithësi situata ishte e qetë dhe pa incidente në zonat e vëzhguara nga KSHH-ja.
- Në ngritjen e qëndrave të votimit dhe vendndodhjes së tyre në përgjithësi është respektuar ligji. Tërheqja e bazës materiale në zonat e vëzhguara është bërë në kohë.
- Përsa i përket procedurave paraprake për hapjen e votimit, disa qendra votimi janë hapur me vonesë për shkak të ardhjes me vonesë të anëtarëve të komisionit dhe vonesës të përgatitjes paraprake dhe mosqënies i pranishëm të të gjithë anëtarëve.
- Përsa i përket procedurës së votimit janë konstatuar raste të votimit familjar. Në disa qendra votimi, kutitë e votimit u mbushën shpejt, sepse fletët e votimit ishin të madha. KQZ-ja duhej të parashikonte këtë problem dhe duhej ta ivitonte atë. Nga vëzhguesit tanë nuk ka patur informacione që tejmbushja e kutive të këtë sjellë pamundësinë e votimit ose të largimit të zgjedhësve pa votuar.
- Përsa i përket mbylljes së votimit dhe numërimi i votave, vëzhguesit e KSHH-së informuan se në përgjithësi procesi pas mbylljes së qëndrës së votimit ishte i rregullt. Numërimi i votave u zgjat shumë sidomos në qendrat e votimit të Bashkisë së Tiranës. Sipas gjykimeve tona, kjo situatë erdhi si rrjedhojë e mungesës së trajnimit, të militantizimit të komisionerëve të qëndrave të votimit dhe se për Bashkinë e Tiranës duhej të numëroheshin 2 fletë votimi.

- Vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar gjithashtu se punonjësit e policisë të ngarkuar me ruajtjen e qendrave të votimit, të shoqërimit të materialeve zgjedhore dhe të ndërhyrjeve në rastet kur janë thirrur me vendim të KQV-ve, kanë zbatuar me korrektesë Kodin Zgjedhor, Ligjin mbi Policinë e Shtetit dhe udhëzimin e KQZ-së. Gjejmë rastin të vlerësojmë rolin pozitiv të policisë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë gjatë ditës së votimit, si edhe në mbarëvajtjen e detyrave të tjera të përmendura më lart në këtë paragraf.

#### **IX. Reagimet publike dhe sinjalizime të KSHH-së**

- KSHH, duke ndjekur me vëmendje zbatimin e Kodit dhe udhëzimeve të KQZ-së, në disa raste ka reaguar publikisht duke tërhequr në të njëjtën kohë edhe vëmendjen për disa çështje që kishin të bënin me ngritjen brenda afateve ligjore të KZQV-ve dhe KQV-ve, korrigjimin e listave paraprake, për trajnimin cilësor dhe në kohë të anëtarëve të komisioneve, etj
- KSHH, veç deklaratave publike për disa çështje të rëndësishme që kanë lidhje me zbatimin rigoroz të Kodit Zgjedhor, ka sinjalizuar herë pas here edhe KQZ-në. Edhe gjatë ditës së votimit, ky komunikim konstruktiv ndërmjet KSHH-së dhe KQZ-së ishte evident. KSHH vëren me kënaqësi se KQZ ka mirëpritur dhe ka vlerësuar pozitivisht sugjerimet e këtij Komiteti.

***Tiranë, më 13 Tetor 2003***